



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:109731

Datë: 20.04.2022

Numri i dokumentit: 02935360

P.nr.1016/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL gjyqtari i vetëm gjykues, Shabi Idrizi, me praktikantin Egzon Krasniqi, në çështjen penale kundër të pandehurit E.K nga Suhareka , për shkak të veprës penale “asgjësimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës” nga neni 367 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj në PP.II.nr.206-1/19 të datës 27.11.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 15.04.2022, në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit të shtetit Zana Sadiku-Sertolli, të pandehurit E.K me mbrojtësin e tij me autorizim av.Muhamet Hoxha, me dt. 19.04.2022 mori dhe publikisht komunikoi ndërsa me datë 20.04.2022 përpiloi , këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **E.K** , i lindur me, në Suharekë me vendbanim në Rr. “...”, p.n, Suharekë nga i ati Xh. dhe ëma L., e gjinisë L. me numër personal ka të kryer fakultetin ekonomik, ish pronar i firmës “K.... SH.P.K”, i martuar prind i një fëmije, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë ,mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Më datë 08.09.2018, rreth orës 10.15, në rrugën magjistrale Ferizaj-Prishtinë, konkretisht në Qëndren Tregtare “G...”, Ferizaj, i pandehuri-pronar i firmës “K... Sh.P.K”, duke qenë përgjegjës për të krijuar kushte të sigurta të punës, nga pakujdesia dhe në kundërshtim dispozitës të nenit 13 paragrafi 1 nën paragrafi 6 dhe nën paragrafi 16 si dhe nenit 23 nën paragrafi 1 të Ligjit Nr.04/L-161, për Siguri dhe Shëndetin në Punë, nuk ka bërë sigurinë e vendpunishtes duke mos instaluar pajisjet mbrojtëse dhe duke mos vlerësuar rrezikun në të gjitha aspektet, i dëmtuari A.A ka punuar në lartësi prej 2,20 metra pa përdorur helmeten si masë mbrojtëse, në atë mënyrë që derisa i dëmtuari kishte qenë duke punuar në katin e dytë, rrezohet nga skelet dhe bie në tokë, me ç’ rast i dëmtuari ka pësuar **lëndime të lehta trupore** më dëmtim të përkohshëm të shëndetit, të konstatuara në Akt Ekspertimin Mjeko-Ligjore të dates 16.11.2020,

-me këtë ka kryer veprën penale Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e paisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës nga neni 367 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 2 Kodit Penal Republikës së Kosovës

Gjykata në kuptim dispozitës të lartcekur ndëshkimore dhe neneve 2,38,43,71,72, të KPRK-së, si dhe nenit 365 dhe 453 dhe 463 të KPPRK-së, të pandehurin e

G J Y K O N

Të pandehurit E.K i cakton DËNIM ME GJOBË në lartësi prej 800.00 € (tetëqind euro) , të cilën gjobë i akuzuari është i detyruar ta paguaj në afat prej 6 muajsh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi në të kundërtën e mos pagesës e njëjta do të shndërrohet në dënim me burgim ashtu që do ti llogaritet për çdo 20.00 euro një ditë burgim, e gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- **Udhëzohet i dëmtuari A.A që kërkesën pasuro-juridike ta realizon në kontest civil.**

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajnë secili shumën prej 40 € /dyzet euro/ si dhe komfor nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036,

për kompensimin e viktimave të krimit, të paguajnë shumën prej 30 € /tridhjetë euro/, brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Historiku procedural

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzë PP.II.nr.206-1/20 e datës 27.11.2020, e ka ngarkuar të pandehurin E.K nga Suhareka, për shkak të veprës penale “asgjësimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës” nga neni 367 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së .

Gjykata duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj me datën 15.04.2022, mbajti shqyrtimin fillestar, ku prezantuan prokurori i shtetit i cili ka lexuar akuzën dhe ka mbetur në tërësi pranë kualifikimit juridik të veprës penale si dhe prezent ishte edhe i pandehuri E.K me mbrojtësin e tij me autorizim av. Muhamet Hoxha .

Komfor nenit 246 të KPPRK-së të pandehurit pasi që i janë dhënë udhëzimet nga ana e gjyqtarit gjatë shqyrtimit fillestar përkitazi me pranimin e fajësisë, i pandehuri e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat që e ngarkon aktakuza dhe ka shtuar se shpreh keqardhje dhe është penduar thellë, kërkon nga gjykata që ti shqiptoj një dënim sa më të butë, dhe i premtonte gjykatës se nuk do të përsëris vepra të tilla penale dhe mundësisht ti shqiptoj dënim më të butë. Në vlerësimin e pranimit të fajësisë së të pandehurit gjyqtari gjykues komfor nenit 248 par.1 të KPPRK-së, ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit, i cili ka deklaruar nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga i pandehuri meqë një pranim i tillë, është bërë komfor dispozitive ligjore nga neni 248 të KPPK-së, pra në mënyrë vullnetare nga i cili pranim ka mbështetje në të gjitha provat dhe shkresat që përmban aktakuza, i propozoj gjykatës që ta ketë parasysh pranimin e fajësisë, të njëjtin ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj një dënim të paraparë me Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

Mbrojtësi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri i ka propozuar gjykatës që pranimi i fajësisë të aprovohet pasi që i njëjti pranim është bërë në mënyrë vullnetare dhe i njëjti i ka kuptuar beni-fitet e pranimit të fajësisë dhe i propozon gjykatës që gjatë shqyrtimit të sanksionit penal ndaj të pandehurit ti shqiptohet një dënim me te but dhe gjithashtu i ka propozuar gjykatës që ti ketë parasysh rrethanat lehtësuese , pasi që është hera e parë që i pandehuri bie ndesh me ligjin andaj kërkon nga gjykata ti ketë parasysh gjatë marrjes dhe shqyrtimit të sanksionit penal.

Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjyqtari gjykues ka vlerësuar se kërkesat nga neni 248 paragrafi 1 i KPPRK-së janë përmbushur, pasi që:

- I pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë
- Pranimi është bërë vullnetarisht.

Pranimi mbështetet në prova dhe fakte të çështjes penale që përmban aktakuza dhe materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit me aktakuzë dhe atë: Raporti i Oficerit Policor të datës 08.09.2018. Raporti Mjekësor i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm–Qendra–Emergjente Ferizaj me numër të rendor të protokollit 809 të datës 08.09.2018. Raporti Mjekësor i lëshuar Qendra Klinike Universitare-Qendra Emergjente Prishtinë, më numër të protokollit 34860 të datës 08.09.2018. Raporti Klinikës Radiologjike, si dhe raportet tjera mjekësore, në emër të dëmtuarit. Kontrata e Punës e lidhur mes punëdhënësit-pandehurit dhe dëmtuarit. Raporti Zyrtar Inspektoratit të punës me numër 254/2018 të datës 17.09.2018, Raporti i Këqyrjes se vendit të ngjarjes të 08.09.2018. Foto Albumi i vendit të ngjarjes. Akt Ekspertimi Mjeko-Ligjore me numër Reference: 02/2020, e punuar nga eksperti Mjeko-Ligjor Dr. Vesa Kotori, lidhur me llojin dhe natyrën e lëndimeve për të dëmtuari A.A, si dhe provat tjera të cilat gjinden në shkresat e lëndës.

- Akuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike,

Meqenëse i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtari individual komfor nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Vlerësimi i veprimeve ligjore të pandehurit

Vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale “asgjësimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës” nga neni 367 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së, me që

me datë 08.08.2019, vend dhe kohë siç është përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi i pandehuri me veprimet e tij ka konsumuar veprën penale që i vihet në barë me çka ka bërë fillimin e procedurës penale.

Vlerësimi për dënimi e shqiptuar

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese përkatësisht që në shqyrtim fillestar i pandehuri ka pranuar fajësinë, është hera e parë që bie në ndesh me ligjin, dhe gjithashtu i pandehuri ka deklaruar se ka ndaluar së ushtruar veprimtarin punuese në të cilën ka ndodhur aksidenti në vendin e punës, faktin se ishte personalisht bashku me të dëmtuarin në të njëjtin vend, se rasti ka ndodh nga pakujdesia, pendimi ishte i sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, kurse në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese përveç që vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se i akuzuari në të gjitha fazat e procedurës penale ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 38 të KPRK-së përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbejë në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Kompensimi i dëmit dhe shpenzimet procedurale

Komfor nenit 463 të KPPRK-së, gjykata ka udhëzuar të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike ta realizoj në kontest civil,

Në bazë të nenit 450 dhe 451 obligohet i akuzuari në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën paguaj shumën prej 40 € (dyzet euro) si dhe komfor nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036 për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 30 € (tridhjetë euro), brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në bazë të thënave më lartë u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2020:109731
Datë: 20.04.2022
Numri i dokumentit: 02935360

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2020:109731, 19.04.2022

G j y q t a r i

Shabi Idrizi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimet të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.